

MIGENA RIZA

ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË SHQIPE TË VERËTARISË NË KOHËN TONË

Verëtaria ose mjeshtëria e prodhimit, ruajtjes dhe përdorimit të verës ka traditë shumë të lashtë në popullin tonë. Për këtë arsye edhe gjuha shqipe është e pasur me fjalë që i takojnë kësaj fushe, fillimisht të ekonomisë shtëpiake, e më pas si degë e industrisë ushqimore. Në dhjetëvjeçarët e fundit kanë dalë një numër botimesh për verëtarinë, ku specialistët përkatës kanë bërë përpjekje për pasurimin, shqipërimin dhe njësimin e terminologjisë, duke mbledhur termat popullorë në krahina të ndryshme të Shqipërisë. Kosovës dhe në trojet e tjera shqiptare, si edhe duke krijuar vetë terma të rinj të nevojshëm. Duke pasur parasysh se në fjalorët e gjuhës shqipe terminologjia dhe në përgjithësi leksiku i fushës së verëtarisë përfaqësohet në mënyrë mjaft të kufizuar, kjo kumtesë synon t'i shërbejë pasqyrimin më të plotë të terminologjisë së verëtarisë në fjalorët e ardhshëm shpjegues të gjuhës shqipe.

Pasqyrimi i terminologjisë së verëtarisë në FGjSSH

Leksiku i një gjuhe përcaktohet dhe kushtëzohet nga një varg faktorësh jashtëgjuhësor, ndër të cilët është edhe zhvillimi i shkencës dhe i teknikës, e kjo e fundit sjell jo vetëm përsosjen e sistemit të termave dhe të terminologjisë shkencore e teknike, por dhe zhvillimin e gjithë sistemit leksikor në tërësi.

Trajtimi i terminologjisë së verëtarisë ka marrë shkasë nga vepra *“Enciklopedi për vreshtarinë dhe verëtarinë”* (Tiranë, 2012, 869 f.) e prof. Andrea Shundit. Kjo vepër na ka nxitur sepse na jep mundësi të vëzhgojmë pasqyrimin e termave të kësaj fushe tematike në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Jemi mbështetur kryesisht mbi *“Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”* (FGjSSH) (1980), si fjalori me shpjegime më të shtjelluara. Siç dihet fjalorët e botuar pas tij (1984, 2002) ose kanë më pak fjalë, ose shtesat janë të pakta (2006).

Kështu, për të hetuar në mënyrë të plotë pasqyrimin e fjalëve që lidhen mjeshtërinë e prodhimit të verës në *“Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”*, kemi bërë vjeljen e përgjithshme të të gjitha fjalëve që i përkasin fushës në fjalë. Nga vjelja e plotë e fjalëve prej *“Fjalorit”* kemi nxjerrë rreth 122 fjalë që lidhen me veprimtaritë e domosdoshme për prodhimin e verës, ruajtjen, shërbimin, matjen dhe me cilësitë kryesore të saj etj. Kemi bërë një klasifikim të këtyre fjalëve në bazë të tipareve leksiko-gramatikore dhe kemi dalluar se në FGjSSH (1980) në fushën tematike të verëtarisë gjejmë tri klasa fjalësh, të cilat janë: *emrat, mbiemrat dhe foljet*.

Emërtimet i kemi klasifikuar në grupe tematike sipas shërbimit a funksionit, duke u mbështetur te përshkrimi që kanë në fjalor. Nga ky klasifikim kemi dalluar grupet më poshtë:

A. Emra që emërtojnë sende konkrete

Bocë II f. sh. f. 160¹, Bocun m. sh. krahin. f. 160, Fuçi f. sh. 1. f. 514, Gastare f. sh. 2. f. 536, Gotë f. sh. 1. f. 566, Kacek m. sh. 1. f. 755, Kaçup I m. sh. 1. f. 757, Kome f. sh. f. 853, Kungulleshkë f. sh. 2. f. 918, Kupë f. sh. 1. f. 919, Lagjin m. sh. 1. f. 936, Plloskë f. sh. krahin. f. 1510, Poç m. sh. 1. f. 1511, Qelqe f. sh. 1. f. 1593, Rogje f. sh. f. 1669, Vaskë f. sh. 2. spec. f. 2117, Vozë f. sh. f. 2181.

II. Enë dhe pajisje, që përdoren gjatë procesit të prodhimit të verës, për ruajtjen e saj, për matjen e vëllimit, të shkallës së alkoolit etj.; vende të caktuara për procese të ndryshme pune gjatë prodhimit të verës

Alkoolmatës m. sh. f. 25, Kantinë f. sh. f. 780, Matës m. sh. 2. f. 1071, Gaviç m. sh. 1. f. 538, Vençë f. sh. 1. 2. f. 2125, Qilar m. sh. 1. f. 1610.

III. Produktet dhe nënprodukte të tjera të verës

Alkool m. sh. 1. f. 25, Amti f. 1. f. 30, Bërsi f. sh. f. 137, Cipura f. vet. sh. krahin. f. 227, Dukagjin m. f. 384, Fundaq m. f. 516, Fundëri f. sh. 1. kryes. nj. f. 516, Kominë f. kryes. sh. f. 854, Lladron m. f. 1033, Llum m. sh. 2. f. 1041, Llurbëtirë f. sh. 2. f. 1042, Musht m. f. 1189, Pije f. sh. 1. f. 1478, Ponç m. f. 1516, Shampanjë f. f. 1817, Shkumë f. sh. 1. f. 1875, Shollomotkë f. krahin. 1. f. 1884, Trop II m. sh. f. 2030, Uthull f. 1. f. 2100, Verë II f. 1. f. 2134, Vermut m. f. 2135, Uthullirë f. f. 2100.

B. Mbiemra që emërtojnë përgjithësisht veti të verës

Alkoolik mb. f. 25; Athët (i, e) mb. 1. f. 71; Bojëverë mb. f. 162; Brushmë (i, e) mb. 1. f. 184; Butë (i, e) mb. 8. f. 203; Dobët (i, e) mb. 9. f. 353; Ëmbël (i, e) mb. 1. f. 441; Ëmbëlosh mb. f. 442; Fortë (i, e) mb. 20. f. 497-498; Gazuar (i, e) mb. f. 541; Holluar (i, e) mb. 3. f. 690; Kulluar (i, e) mb. 1. f. 911; Kuq (i, e) mb. 1. f. 920; Lehtë (i, e) mb. 4. f. 959-960; Llurbët (i, e) mb. 2. f. 1042; Majhosh mb. f. 1049; Mirë (i, e) mb. 1. f. 1143; Papërzier (i, e) mb. 2. f. 1353; Pëlqyer (i, e) mb. 2. f. 1414; Rëndë (i, e) mb. 4. f. 1655; RI (i, e) mb. 5. f. 1658; Shkumëzues mb. f. 1876; Shkumor mb. f. 1876; Trashë (i, e) mb. 3. f. 2016; Turbullt (i, e) mb. 1. f. 2041; Thartë (i, e) mb. 1. f. 2052; Thartuar (i, e) mb. 1. f. 2053; Uthullaç mb. f. 2100; Uthulluar (i, e) mb. 1. f. 2101; Vjetëm (i, e) mb. f. 2174; Vjetër (i, e) mb. 5. f. 2174

C. Folje dhe emra foljorë që shënojnë veprime lidhur me prodhimin e përdorimin e verës etj.

Alkoolizim m. f. 25, Athtësi f. f. 71, Alkoolizoj kal. f. 25, Athëtohem vetv. 1. vet. veta III. f. 71, Athëtoj kal. 1. f. 71, Deh kal. 1. f. 301, Dehem vetv. 1. f.

¹ Shih: *Fjalori i gjuhës së sotme shqipes*, Tiranë, 1980, f. 160. (Për shpjegimin e kuptimeve të fjalëve duhet t'i referoheni "Fjalorit" në bazë të numrit të faqeve.)

301, Gazoj I kal. f. 540, Gazim m. f. 540, Sheqerim m. kim. f. 1827, Tharmëtim m. spec. f. 2052, Thartim m. 1. f. 2952, Vjetërsim m. f. 2175, Holloj kal. 4. f. 690, Kthjellohem vetv. 1. vet. veta III. f. 901, Kulloj kal. 6. jokal. vet. veta III. f. 910-911, Mushtohet vetv. 1. vet. veta III. f. 1189, Pi kal. 1. f. 1477, Provoj kal. 3. f. 1560, Ruaj kal. 7. f. 1672, Rrushkulloj kal. 3. bised. f. 1722, Shklluq kal. f. 1859, Shkumëzohet jokal. 1. vet. veta III. f. 1876, Shtie kal. 1. f. 1928, Turbulloj kal. 1. f. 2040, Tharbëtohem vetv. 1. vet. veta III. f. 2051, Tharbëtoj kal. 1. f. 2051, Tharet vetv. f. 2051, Tharmëtohet vetv. spec. f. 2052, Tharmëtoj kal. spec. 1. f. 2052, Thartohem vetv. 1. vet. veta III. f. 2952; Uthullohet vetv. 1. f. 2101; Uthulloj kal. 1. f. 2101; Vjetërsohem vetv. f. 2175; Vjetrohëm vetv. 3. vet. veta III. f. 2175; Zbut kal. 9. f. 2219; Zhabarit kal. 1. f. 2255.

“*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*” (1980), edhe pse është një fjalor i tipit të mesëm, vazhdon ende të jetë fjalori më i plotë deri më sot i gjuhës shqipe, sidomos nga pikëpamja e zbërthimit dhe ilustrimit të kuptimeve të fjalëve, si dhe e pajisjes me shënime stilistike e terminologjike. Fjalët janë dhënë në “*Fjalor*” si një tërësi organike fonetike, leksikoro-semantike e gramatikore, duke pasqyruar shpjegimet e fjalës, frazeologjinë, shënimet gramatikore, stilistikore, etimologjike etj.

Vlen të theksojmë se në “*Fjalor*” jepen shkurtime të ndryshme për fjalët, për kuptimet, për togjet e fjalëve, për frazeologjinë dhe për disa thënie dhe, konkretisht shkurtime të ndryshme që karakterizojnë veçoritë stilistike sipas ligjëtimeve dhe për sferat e përdorimit të tyre.² Pra, vëmë re se lidhur me sferën tematike të verëtarisë nuk është përdorur ndonjë shënim apo shkurtime i tipit *ver.* (verëtar). Arsyet e mospërdorimit të një shënimi të tillë për fushën e prodhimit të verës dhe për vetitë e saj nuk mund t’i pohojmë plotësisht dhe në mënyrë të sigurt, por do të parashatrojmë ndonjë shpjegim.

Dihet se “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*” është fjalori i dytë shpjegues pas “*Fjalorit të gjuhës shqipe*” (1954), kështu që ka munguar një traditë, një përvojë e plotë për dhënien e veçorive stilistike, për ngjyrimet emocionale të fjalëve si dhe për shënimet për sferat e përdorimit të fjalëve. Në mungesën e një tradite të tillë në leksikografinë shqiptare, “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*” bëri ndoshta një hap të rëndësishëm përpara për një vlerësim të tillë në mënyrë sistemore dhe sa më gjithëpërfshirëse të fjalëve të gjuhës shqipe. Në këto rrethana sfera të veçanta mund të jenë përjashtuar në mënyrë të pavetëdijshme nga një vëzhgim i tillë sistemor.

Burimet dhe mjetet kryesore për formimin e termave të rinj të verëtarisë

Zhvillimi, pasurimi e rregullimi i terminologjisë teknike e shkencore është tregues i rëndësishëm për zhvillimit e leksikut në tërësi. Pasurimi i vazhdueshëm i kësaj shtrese të leksikut shtrën detyra të reja për

² Shih: *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. XX.

leksikografinë, leksikologjinë dhe studimet në fushën e fjalëformimit, por dhe për gjuhësinë shqiptare në përgjithësi. Lëvizjet që ndodhin në terminologji (hyrje termash të rinj, diferencime kuptimore, dalje nga përdorimi i termave të vjetruar) ndihmojnë në hetimin e fakteve të reja gjuhësore që lindin në fusha të ndryshme tematike, si dhe për të kuptuar mënyrat, mjetet dhe modelet, pra gjedhet fjalëformuese më prodhimtare të gjuhës sonë, sidomos gjatë dy dekadave të fundit.

Deri më sot në studimet terminologjike nuk është trajtuar si fushë e veçantë terminologjia e mjeshtërisë së prodhimit të verës, pra e verëtarisë. Ka munguar një punim me karakter gjuhësor për mjetet, mënyrat dhe rrugët e formimit të leksikut terminologjik që lidhen me këtë fushë tematike. Studimi i terminologjisë së verëtarisë në këtë punim do të ketë si bazë lëndën gjuhësore të nxjerrë nga *“Enciklopedia e vreshtarisë dhe e verëtarisë”* e prof. Andrea Shundit, e cila është një vepër që ka bashkërenduar në mënyrë harmonike njohuritë nga botimet më bashkëkohore vendëse dhe të huaja, praktikën vreshtare dhe verëtare mbarëshqiptare si dhe përvojën e vetë autorit³. Synimi kryesor do të jetë të vëmë në dukje së pari pasurinë leksikore të kësaj fushe, faktorët që kanë ndikuar në zhvillimin e saj, rrugët kryesore të pasurimit të saj si dhe të analizojmë mënyrat kryesore të formimit të termave të rinj të kësaj fushe nga veprimtaria e vetëdijshme e specialistëve.

Pasurimi i gjuhës shqipe më terma të rinj në mënyrë të vetëdijshme e të planifikuar nis që me rilindësit. Një ndër detyrat kryesore të tyre ishte të hidhnin themelet e terminologjisë së gjuhës shqipe, detyrë që sot e kanë jo vetëm specialistët e fushave të ndryshme të teknikës dhe shkencës, individë dhe dashamirës të gjuhës, por mbi të gjitha institucionet gjuhësore për të vazhduar zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe si një gjuhë e kulturës, e shkencës dhe teknikës.

Ndryshimet e mëdha politike dhe ekonomike që ndodhën në Shqipëri pas viteve '90, hapja e vendit, kanë sjellë zhvillimin me ritme të shpejta në shumë fusha, duke mundësuar kalimin nga një sistem krejtësisht i centralizuar drejt ekonomisë së tregut. Por dhe përshtatja me globalizmin si një prirje ndërkombëtare ka ndikuar në zhvillimin e fushave të ndryshme të prodhimit. Për rrjedhojë, këta faktorë janë pasqyruar edhe me ndryshime të leksikut të përgjithshëm, por dhe të fushave të veçanta leksiko-semantikore, duke prodhuar fjalët-terma të rinj. Lidhur me verëtarinë, por dhe vreshtarinë mund të citojmë nga *“Enciklopedia”* se *“Tashmë, këto veprimtari i kanë kapërcyer caqet e profesionistëve dhe dashamirëve të tjerë, të cilët merren me to, i përkasin botës së tërë, prodhuese dhe përdoruese të rrushit e të verës, botës ekonomike dhe kulturore, shoqërisë njerëzore.”*⁴.

³ Shih: A. Shundi, *Enciklopedi për vreshtarinë dhe verëtarinë*, Tiranë, 2012.

⁴ Shih: A. Shundi, *Enciklopedi për vreshtarinë dhe verëtarinë*, Tiranë, 2012, f. 10.

Leksiku terminologjik si formë e shprehjes së koncepteve shkencore dhe teknike gjallon në një lidhje të pandërprerë me zhvillimet që pëson shkenca dhe teknika, zhvillimi i kulturës materiale dhe shpirtërore, duke shpalosur karakterin dinamik të zhvillimit të gjuhës si gjuhë e shkruar, por dhe si gjuhë kulture. Të gjithë proceset e sipërpërmendura kanë në themel të tyre ndryshime me karakter jashtëgjuhësore që bëhen shtysë dhe burim për ndryshimet gjuhësore, për lindjen e termave të rinj në fusha të veçanta, madje dhe për sisteme të tëra terminologjike. Në fushën e verëtarisë (*enologjisë*) është e nevojshme të gjurmohet jo vetëm lindja e fjalë-termave të veçantë, por edhe të ndërtohet një “*sistem terminologjik i ri*”⁵ që lind në gjirin e kësaj fushe tematike. Ky sistem terminologjik do të sjellë ndihmesën në shprehjen e nocioneve të veçanta që lidhen me fushën në fjalë, por do të ndihmojë edhe në ngulitjen e tyre si terma të rinj, të ngjizur gjuhësisht hijshëm, që do të mund t’i qëndrojnë kohës dhe do të bëhen pjesë e fjalorëve të ardhshëm shpjegues të gjuhës shqipe si një leksik special.

Në dhjetëvjeçarët e fundit kanë dalë një numër botimesh për verëtarinë, ku specialistët përkatës kanë bërë përpjekjen për pasurimin, shqipërimin dhe njësimin e terminologjisë duke mbledhur terma popullorë në krahina të ndryshme të Shqipërisë, Kosovës dhe në trojet e tjera shqiptare, por dhe duke krijuar në mënyrë të vetëdijshme terma të rinj të nevojshëm. Prirja kryesore e gjuhës sonë ka të bëjë me plotësimin e nevojave të reja leksikore në të gjitha fushat me mjetet e veta fjalëformuese. Duke analizuar “*Enciklopedinë për vreshtarinë dhe verëtarinë*” kuptojmë se dhe kjo fushë tematike është pasuruar mjaft me fjalë-terma, krahasuar me fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe të 1980-ës (tek ky i fundit nga çështja “*Pasqyrimi i terminologjisë së verëtarisë në FGjSSH*” vëmë re se terminologjia, në përgjithësi dhe, leksiku i verëtarisë përfaqësohet në mënyrë mjaft të kufizuar).

Si fillim, puna jonë me këtë vepër ka qenë vjelja shteruese e fjalëve që lidhen me verëtarinë, duke përjashtuar nga vëzhgimi ynë termat që lidhen me vreshtarinë. Për të nxjerrë në pah pasurimin e kësaj fushe terminologjike, kemi veçuar dhe përzgjedhur kryesisht fjalët me burim nga brumi i shqipes, si dhe fjalët e prejardhura me temë të huaj, por me prapashtesa ose parashtesa shqipe dhe që nuk gjenden në fjalorin e 1980-ës. Me prirjen kryesor për të pasqyruar pasurimi e kësaj fushe me terma të rinj të krijuar nga veprimtaria e vetëdijshme e specialistëve, kemi bërë analizën për përcaktimin e burimit, duke treguar mënyrën dhe mjetet e formimit të tyre.

Terma kompozita

⁵Shih: Pasqyrimi i termave të rinj është dhënë te çështja: *Terma të verëtarisë të paregjistruar në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, të nxjerrë nga vepra “Enciklopedi për vreshtarinë dhe verëtarinë”*.

Në terminologjinë e verëtarisë vëmë re se një numër fjalësh-terma të rinj janë kompozita. Dallojmë kryesisht kompozitat përcaktore, të formuara nga bashkimin i një teme emërore me një tjetër temë emërore (gjymtyra e dytë është një emër prejfoljor) p.sh., *mushtmatës*; *shishekulluese*; *shishelarëse*; *shishembajtëse*; *shishembushëse*, *shishepjerrëtim*. Në këto kompozita dallojmë se gjymtyra e parë përcaktohet nga gjymtyra e dytë pra, *mushtmatës: matës i mushti*; po kështu: *larës i shisheve*, *mbajtëse e shisheve*, *mbushëse e shisheve*, *pjerëtim i shisheve*, etj.

Terma të krijuar me prapashtesa

Një numër i mjaft i rëndësishëm i termave të rinj janë formuar nëpërmjet prejardhjes prapashtesore. Këta po i paraqesim të grupuar sipas prapashtesës përkatëse:

1) **-im**: si: *amësim*, *bukëzim*, *erësim*, *flokëzim*, *frigoriferim*, *gjerbim*, *kanëzim*, *kësulëzim*, *lisnim*, *moshim*, *mushtim*, *mykëzim*, *ngjërim*, *pjekurim*, *qilarim*, *rienëpsim*, *rrëjullim* (arb.), *shishezim*, *shkumim*, *trokullim*, *tharmëzim*, *thartorim*, *verëtim*, *verëzim*.

Prapashtesa *-im* te fjalët e mësipërme është bashkuar me një temë foljore, folja përkatëse mund të ekzistojë e të përdoret si e tillë në leksikun e përgjithshëm (p.sh. *erëmon*, *ngjëroj*, *shkumom*), ose mund të përdoret si term në verëtarin, p.sh. *amësohet*, *flokëzohet*, *pjekurohet* etj.). Por te vepra “*Enciklopedia*” e prof. Andrea Shundit janë renditur vetëm termat emra, ndërsa termat folje mund të gjenden duke lexuar tekstin.

Me prapashtesën *-im* janë formuar emërtime te të cilat motivimi nuk del i qartë, në të shumtën e shembujve sepse nuk lidhet drejtpërdrejt me temën emërore ose foljore, por mënyra e motivimit mund të shpjegohet vetëm duke u bazuar te shpjegimi semantik që secila fjalë ka në fjalor p.sh., *frigoriferim* nuk lidhet me frigoriferin, por me funksionin kryesor që kjo pajisje ka, pra me ftohjen, ose *gjerbim* nuk ka të bëjë thjesht me temën foljore *gjerb* “pi duke thithur nga pak, surb; ha nga pak një ushqim të lëngshëm”, por këtu lidhjet me pirjen e ngadalshme, që vera të shijohet më mirë dhe që ajo të mos të dëmtojë etj.

2) **-or**: me këtë prapashtesë është formuar termi *mushtor*, që tregon një lloj vere me musht.

3) **-tore**: me këtë prapashtesë janë formuar terma të gjinisë femërore si *mbushtore*, *tharbtore*, *uthulltore*, *verëtore*, ku në dy rastet e para si temë fjalëformuese ka shërbyer një foljet, përkatësisht folja *mbush* dhe *tharb* dhe në rastet e dyta si tema fjalëformuese kanë shërbyer emrat, përkatësisht *uthull* dhe *verë*. Në të gjitha rastet termat janë emra konkret që emërtojnë pajisje ose mjedise të veçanta që lidhen më teknologjinë e prodhimit, ruajtje, ambalazhimit apo dhe tregtimit të verës.

4) **-ëz**: me këtë prapashtesë janë formuar termat: *kafazës*, *kësulëz* dhe *qaforez* te të cilët motivimi është i qartë. Janë tre terma që i përkasin

kategorisë leksiko-gramatikore të emrit dhe që po ashtu na dalin në gjininë femërore. Kjo prapashtesë zvogëluuese (në rastin e fjalë-termave përjashtohet ngjyrimi përkëdhelës i saj) motivon semantikën e saj dhe te termat e mësipërm, sepse nga shpjegimet e tyre në fjalor del e qartë se bëhet fjalë për disa pajisje në përmasa të vogla.

5) -os: me këtë prapashtesë është formuar termi *thartosh*, i cili ka si temë fjalëformuese mbiemrin *i thartë*, për të treguar dhe motivuar semantikisht cilësinë e lëngut të rrushit, që në këtë rast është i athët ose më i athët se normalja.

6) -ues(e), -ës(e): me këtë prapashtesë janë formuar termat: *kësulëzuuese*, *kthjellues*, *mushtues*, *ngjërues*, *shishezuese*, *thartuese*, *nisës*, *taposëse* - këto fjalë emërtojnë një pajisje ose një person, që kryen veprimin sipas kuptimit të temës fjalëformuese foljore: *kësulëzuuese* “pajisje që vendos kësulëzat...”, *ngjërues* “specialist për vlerësimin e verërave duke i ngjëruar ...” etj.

7) -tar: me këtë prapashtesë është formuar termi *verëtar*, si temë fjalëformuese ka shërbyer emri *verë* (sipas gjedhes *vresht* – *vreshtar*) dhe te ky term motivimi është i qartë.

8) -(shm)ëri: me këtë prapashtesë janë formuar termat: *alkoolshmëri*, *pijshmëri* (nga *i pijshëm* – *pijshmëri*, por *i alkoolshëm* nuk ekziston prandaj këtu kemi prap. -shmëri, d.m.th. prapashtesë e formuar nga bashkimi i dy prapashtesave).

9) -je: prapashtesa -je ka formuar termin *shklluaje* “Pirje njëherësh e bardhakut me verë ose me raki.”

Terma të krijuar me parashtesa

Prejardhja del dhe në disa terma të formuar nëpërmjet parashtesave, që nënkupton formimin e termave të rinj me prefikse. Kjo mënyrë fjalëformimi ka prodhuar këto fjalë-terma të rinj: *rienësim*, *rimbëltim*, *ritharmim*, *shsqufurim*, *shtaposje*, *shthartim*, *zhgazim*. Pra, si parashtesa na dalin *ri-* me kuptimin e përsëritjes së një veprimi *rienësi* (enësim), *rimbëltim* (mbëltim), *ritharmim* (tharmim), *sh-* dhe *zh-* me kuptim antonimik *shsqufurim* (squfurim), *shtaposje* (taposje), *shthartim* (thartim), *zhgazim* (gazim). Theksojmë se prefikset u janë paravendosur emrave prejfoljorë duke formuar sërish emra të këtij lloji. Me parashtesa *mbas-* është formuar termi *mbasshije*.

Terma togfjalësha

Siç dihet, krahas termave njëfjalësh, ka edhe togfjalësha terminologjike ose terma togfjalësh. Kjo dukuri vihet re dhe në terminologjinë e verëtarisë, nocione nga terminologjia e verëtarisë janë të shprehura në fjalor nëpërmjet togfjalëshave, pra togfjalësha-terma të tillë si: *botërizim i verës*, *fisnikërim i verës*, *moshim në shishe*, *pjekurim i verës*, *tymëzim i vozave*, *shitore vere*, *ripërtëritje e verës*. Tipi kryesor në sintagmat e mësipërme është ndërtimi *emër + emër në rasën gjinore* (botërizim i verës, fisnikërim i verës, moshim në

shishe, pjekurim i verës). Kemi edhe tipin tjetër *emër+emër në rasën kallëzore me parafjalë* (moshim në shishe) dhe po ashtu *emër+emër në rrjedhore* (shitore vere).

Kalke semantik

Një tip i veçantë ndërtimor në fushën e terminologjisë së verëtarisë janë edhe kalket kuptimore (semantike), të ndikuara kryesisht nga anglishtja dhe italishtja, por të rikonceptuara sipas natyrës së gjuhës shqipe. Kalke kuptimore kemi në rastet kur struktura kuptimore e një fjale të njohur shqipe pasurohet me një kuptim të ri terminologjik, që e ka fjala gjegjëse në një gjuhë tjetër. Të tilla janë p.sh. kuptimet si terma të verëtarisë të fjalëve *kokë* dhe *hënz*, përkatësisht: *kokë* “Shkuma dhe fluskat, që krijohen mbi mushtin në tharmim ose kur **vera shkumuese** zbrazet nga shishja në bardhak.”; *hënz* “Letër në etiketë, në trajtë hënëze dhe me ngjyra të ndryshme, që ngjitet në shishen me verë.”.

Te këta terma është marrë modeli i gatshëm prej anglishtes dhe italishtes, kështu për (ang.) *Lunette*; (ital.) *Lunetta* në shqip është përshtatur kuptimisht *hënz* dhe për (ang.) *Head*; (ital.) *Tésta* është dhënë *kokë*, pra për shqipërimin e termave të huaj është përdorur kalkimi.

Prejardhja semantike

Dhënia e kuptimeve të ngushta terminologjike fjalëve të zakonshme është një dukuri që ka prekur dhe terminologjinë e verëtarisë. Kjo është një rrugë që pasuron sistemin terminologjik të fushës në fjalë, por zgjeron edhe përbërjen semantike të vetë fjalës. Prejardhja semantike është bërë burim për lindjen e kuptimeve të reja të fjalëve.

Kështu, po t'i referohemi “*Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*” vëmë re se fjala *stringël* ka dy kuptime: 1. “Stoli të vogla prej metali, që i varin gratë në gjoks, në brez etj.” 2. “Sende të vogla zbukurimi, që vihen në rafte, mbi oxhak etj.”; ndërsa kjo fjalë në “*Enciklopedia*” e prof. Andea Shundit ka këtë kuptim “Copë e zbukuruar prej kartoni të hapur ose të palosur, ku shënohen tregues domethënës për verën dhe kantinën.” Nga krahasim kuptohet qartë se nga kuptimi i dytë që kjo fjalë ka në “*Fjalor*” ka lindur një kuptim i ri që lidhet me terminologjinë e verëtarisë. Dukuria e zgjerimit kuptimor vihet re dhe te fjalët *kësulë*, *përkorje*, *kësulë*.

Terma të verëtarisë të paregjistruar në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, të nxjerrë nga vepra “*Encikpedi për vreshtinë dhe verëtarinë*”

Alkoolshmëri: Shkalla e pranisë së alkoolit në verë, që tek pirësi, ngjëruesi i saj, jep ndjesinë e një ngrohtësie/nxehtësie të rreme, më pak ose më shumë e theksuar. (ang.) *Alcohol content*; (ital.) *Alcolicità*.⁶

⁶ Shih: A. Shundi, *Enciklopedi për vreshtarinë dhe verëtarinë*, Tiranë, 2012. Shënim: Edhe për termat e tjerë duhet t'i referohemi veprës në fjalë.

Amësim: Cilësi shqisore, erëmirim më se i këndshëm dhe i veçantë, që kryesisht përmbahet në lëvore të rrushit. Në verë, amësimi vjen nga thartorët, alkooli, aldehidet, esteret etj. Amësimin mund ta ketë rrushi, mushti, vera deri 1–2-vjeçare. Në njëfarë mënyre, amësimi përfshin dhe bashkërendohet duke ndikuar ndërsjelltas me shijen. Amësimi është përbërës i tufës së verës, sepse tufa ka tërësi amësimesh dhe shijesh shumë të pëlqyera. Sin.: *Ajht* (arb.), *Aromë*, *Eri* (arb.), *Merë* (arb.), *Mirëz*. 'Amësimi shpreh shpirtin e verës'. (ang.) *Aroma*, *Flavor*, *Fragrance*; (ital.) *Aróma*, *Fragránza*.

Billëke: Enë prej qelqi, shishe e madhe, damixhanë e vogël ku mbahet verë ose raki.

Bluzhdë: Grimca jo aq të vogla, por jo aq të shumta. Bluzhda zakonisht vërehet në verën e thartuar, të prishur; por pse jo edhe në verën e fundërruar. *Bluzhde* (sin.) Shih: *Bërsi*. *Trop* (sin.) Shih: *Bërsi*. (ang.) *Small particles*; (ital.) *Piccole particelle*.

Botërizim i verës: Ndërkombëtarizim në rritje i natyrës së industrisë së verërave, ku përfshihen praktikatat e administrimit të vreshtave, teknologjitë e prodhimit dhe stilet e verërave, tregtimi i verërave. Sin.: *Globalizim i verës*. (ang.) *Wine globalization*; (ital.) *Globalizzazione del vino*.

Bukëzim: Proces i terjes dhe i ngjeshjes në trajtë buke i bërsive, për t'u bartur më lehtë dhe ruajtur më afatgjatë. (ang.) *To knead*; (ital.) *Impastazione*.

Çutër: Enë prej druri, ku rrushi shtypet/dërrmohet dhe mushti tharmohet për prodhim vere. Sin.: *Çutërr*. (ang.) *Wine cask*; (ital.) *Vaso vinario*. *Çutër* (sin.) Shih: *Bucelë*.

Erëmirim: Vetë që përftohen nga shqisa e të nuhaturit, kur njeriu merr erë rrushi dhe vere. Sin.: *Eratim*, *Erë*, *Mirisje*, *Mirixje* (arb.). (ang.) *Odour*, *Smell*; (ital.) *Odore*.

Fisnikërim i verës: Lartësim dhe përmirësim tërësor i cilësive të verës, bërja më e qëndrueshme e saj; **stabilizim** i cilësive nëpërmjet evoluimit natyror të verës dhe veprimtarisë së verëtarit. (ang.) *Wine's improvement*; (ital.) *Affinamento del vino*.

Flokëzim: Proces fundërrimi të fundërrisë koloidore, çka edhe në verë, nën veprim të një elektroliti. Sin.: *Flokulim*. (ang.) *Flocculation*; (ital.) *Flocculazione*. *Flokulim* (sin.) Shih: *Flokëzim*.

Frigoriferim: Ftohje deri në shkallë tejftohjeje të **kantinës/qilarit** ose të enëve me verë, me qëllim ndërprerjeje të tharmimit të mushtit ose për **pjekurim** dhe **moshim** më të mirë të verës. (ang.) *Refrigeration*; (ital.) *Frigorificazione*.

Gjerbim: Pirje vere, në sasi aq sa merret në gojë me një të gëlltitur, kur vera thithet një herë në bardhak. Pihet pak e me ngadalë, që vera të shijohet më mirë dhe të mos dëmtojë. Pihet pak, për ta **ngjëruar** verën. 'Gjerbim vere do të thotë shijim i një pikële nga lumi i historisë së njerëzimit'. Sin.: *Hurbim*, *Kurpim*, *Rrufitje*, *Surbim* (ang.) *To sip*; (ital.) *Centellinare*, *Sorbire*, *Sorseggiare*, *Succhiare*.

Hënëz: Letër në etiketë, në trajtë hënëze dhe me ngjyra të ndryshme, që ngjitet në shishen me verë. Në etiketë, shënohet viti i prodhimit të verës dhe ndonjë tregues tjetër, përcaktuar nga BE. (ang.) *Lunette*; (ital.) *Lunétta*.

Kacë: Enë e madhe prej druri, shumëpjesëshe: fundori, fletët prej druri, rrathët petashuq metalorë, **lëfyti** ose rubineti, kapaku i sipërm. Kaca përdoret për shtypje rrushi, për tharim mushti. **Sin.:** *But, Gaviç, Mtanë*.

Kafazëz: Skelet prej **teli** të hollë, ngulitur në qafën e shishes. Kafazëza nuk lejon shpërthimin e tapës së shishes me **verë shkumuese**, për shkak të trysnisë së dyoksidit të karbonit. (ang.) *Small cage, Wire hooding*; (ital.) *Gabbietta*.

Kalcnicë: Kupë prej balte të pjekur, që përdoret për pirje vere. **Sin.:** *Kupore, Urtunë*.

Kanëzim: Kalim, zbrazje e verës nga shishja ose voza, në kanë qelqi dhe aq më mirë prej kristali, me qëllim ajrimi, çlirim amësimi, fundërrimi më të mirë të verës. Kanëzimi kryhet rreth 30 minuta përpara pirjes së verës. (ang.) *Caning, Decanting*; (ital.) *Decantazione, Scaraffatura*.

Kësulë: Tërësi lëndësh të ngurta që pluskojnë mbi sipërfaqen e mushtit në tharim. **Sin.:** *Kapele, Kapuç*. (ang.) *Cap of skins, Pomace cap*; (ital.) *Cappello emerso*.

Kësulëz: Fletë e hollë prej alumini, varaku ose plastike; në trajtën e një kësule të vogël, mbështjell e mbulon tapën dhe sadopak qafën e shishes me verë. Kësulëza e mbron tapën nga ndonjë kandërr ose lagje, shishen me verë e hijeshon më shumë. **Sin.:** *Kapsulë, Kapuç, Këllëf*. (ang.) *Kapsule, Foil*; (ital.) *Cápsula*.

Kësulëzim: Mbështjellje, veshje e kokës dhe e qafës së shishes me verë, pas taposjes së saj, me një kësulëz. Kësulëzimi synon mbrojtjen nga papastërtitë dhe hijeshimin e shishes.

Sin.: *Kapsulim, Kapuçim*. (ang.) *Capsuling*; (ital.) *Capsulazione*.

Kësulëzuese: Pajisje për mekanizimin e vendosjes më shpejt e mirë, të kësulëzave mbi tapat e shisheve me verë. (ang.) *Equipment for capsuling*; (ital.) *Capsulatrice*.

Kokë: Shkuma dhe flluskat, që krijohen mbi mushtin në tharim ose kur **vera shkumuese** zbrazet nga shishja në bardhak. (ang.) *Head*; (ital.) *Tésta*.

Kthjellues: Lëndë organike dhe minerare (**bentonit**) dhe proteinore (**e bardhë veze, xhelatinë, kazeinë**, albuminë gjaku), që në sasi dhe në periudhë të caktuar, përdoren për **kthjellimin** e verës. (ang.) *Finning agents*; (ital.) *Chiarificanti*.

Lisnim: Përfitim amësimi dhe shije të posaçme në verë, përmes **pjekurimit** e **moshimit** të saj në vozë druri prej lisi ose duke shtuar ashkla lisi në enën me verë. (ang.) *Oaking*; (ital.) *Querciaménto*.

Mbasshije: Shija që vera vijon të mbetet në gjuhë dhe në qiellzë mbas pirjes së një gllënjke verë cilësore; çmohet sa më gjatë vijon shija e verës në gojë. (ang.) *Finish, Length*; (ital.) *Raffinátézza*.

Mbushtore: Dhomë ose sallë zakonisht në mjedis veças nga kantina. Në mbushtore ka makineri dhe pajisje që përdoren për larjen e shisheve, për mbushjen

me verë, për **etiketimin, taposjen, kësulimin**. **Sin.:** *Linjë ambalazhimi*. (ang.) *Bottling line*; (ital.) *Linea d'imbottigliamento, Caténa d'imbottigliamento*.

Moshim: Cikël zhvillimi i verës pas **pjekurimit** të saj, që shoqërohet me ndryshime në veçori të përbërësve dhe të cilësive shqisore të saj; ndryshime me natyrë fizike, kimike, biologjike. Moshimi përbën një proces natyror të ngadalshëm për disa ose shumë vite, ku vera pëson ndryshime të rëndësishme, që kulmojnë me krijimin e **tufës** me amësime. (ang.) *Ageing*; (ital.) *Invecchiamento*.

Mushtim: I. Proces i **shtypjes** së rrushit për të përfutur musht, që menjëherë vihet në enët përkatëse për t'u tharmuar në verë. (ang.) *To turn into must*; (ital.) *Ammostamento*. *Mushtim* (sin.). Shih: *Lëngëzim i hardhisë*. Shih: *Pjekje e rrushit*.

Mushtor (arb.): Verë që ende ka pak a shumë musht, prandaj vijon t'i ndihet shija e mushtit.

Mushtmatës: Pajisje e thjeshtë prej qelqi, që vihet të pluskojë në lëngun e rrushit, në musht, në verë. Mushtmatësi shërben për të matur **dendësinë vëllimore** të lëngut. **Sin.:** *Mushtmetër, Hidrometër, Sakarometër*. (ang.) *Hydrometer, Densimeter*; (ital.) *Idrómetro, Sacarómetro, Mostimetro*.

Mushtues: Enë e madhe dhe e thellë, me kapak dhe zakonisht prej druri (kacë, kade, tinar etj.), që shërben për **shtypjen** dhe mushtimin e rrushit. (ang.) *Grapes press*; (ital.) *Ammóstatoio*.

Mykëzim: Erëhim dhe shije myku, zakonisht i pëlqyer në rrush dhe në verë. (ang.) *Mouldy*; (ital.) *Ammufiménto*.

Ngjërim: I. Veprimtari e mirëfilltë për **vlerësim shqisor** të verës. Pirja e njëdy gllënjave verë, për të përcaktuar a hetuar vlera të saj, nëpërmjet shqisave të njeriut, i cili ngjeron dhe vrojton e shijon: ngjyrën, erëhimin, shijen, kthjelltësinë; pra kryhet vlerësim shqisor i verës. **Sin.:** *Degustim, Ngallim, Ngolim, Ngjepsje* (arb.), *Ngjironje* (arb.), *Shijesim, Testim*. (ang.) *Degustation, Tasting*; (ital.) *Degustazione, Assaggio*.

Ngjërues: Njeri i specializuar për **ngjërimin** dhe vlerësimin e verërave, veçanërisht për shkallën e zhvillimit të tyre; ngjëruesi po ashtu parasheh kohëzgjatjen e ruajtjes së veçorive cilësore të verërave. Ngjërues quhet edhe blerësi, i cili përpara blerjes, shpesh e ngjeron verën. Ngjërues është cilido që ka njohuri për verën. (ang.) *Taster*; (ital.) *Assaggiatore, Degustatore*.

Nisës: Sasi e vogël mushti të pasur me tharme, për ta shtënë dhe përzier në mushtin që ka vështirësi tharmimi ose kur duhet përmirësuar cilësia e tharmimit. **Sin.:** *Starter*. (ang.) *Starter*; (ital.) *Stárter*.

Përkorje: Vetëpërmbytje, pirje me masë e verës dhe në kohën e duhur. (ang.) *Temperance, Moderation*; (ital.) *Continénza*.

Pijshmëri: Shkalla e pirjes ose periudha kur vera është e mirëfilltë, e gatshme për t'u ngjëruar dhe pirë. (ang.) *Drinking rate, Wine consumption*; (ital.) *Béva*.

Pjekurim dhe/ose moshim në shishe: Vendosi e verës në shishe, me të përfunduar stabilizimi i saj, me qëllim që pjekurimi dhe/ose **moshimi** të kryhet në shishe, jo në vozë druri ose në rezervuar inoks. (ang.) *Bottle maturation and/or bottle aging*; (ital.) *Maturazione e/o invecchiamento nélla bottiglia*.

Pjekurim i verës: Procese biologjike, kimike, fizike në vijimësi që zhvillohen për 6–18 muaj në verë, zakonisht të kryera në vozë, por mundet edhe në vaskë a rezervuar, pas **tharmimit alkoolor** të mushtit, deri në **shishezimin** e verës, për të përfutur dhe ngulitur më plotësisht cilësitë e saj: ngjyrën, shijen, amësimin. Pjekurimi i verës vijon edhe gjatë mbajtjes në shishe. **Sin.:** *Maturim i verës.* (ang.) *Wine maturation*; (ital.) *Maturazione del vino*.

Qaforez: Rrip letre të bardhë ose të ngjyrosur, që ngjitet në qafën e shishes me verë, ku shënohet: emri i **kantinës**, prejardhja dhe lloji i verës. (ang.) *Small collar*; (ital.) *Collarino*.

Qilarim: I. Procese prodhimi të verës sidomos: **kthjellimi**, **përzierja** me verëra të tjera, **moshimi**, **shishezimi**. Në qilarim nuk përfshihet periudha e parë, ajo e **shtypjes** dhe e **shtrydhjes** së rrushit, **tharmimit** të mushtit. II. Ruajtja e verës në **kantinë**, **qilar** ose mjedis tjetër të përshtatshëm. (ang.) *Cellaring*, *Vinification*; (ital.) *Vinificazione*.

Rienësim: Zhvendosje me anë të një gypi llastiku në trajtë sifoni ose me kacek, por sidomos me pompim, kryesisht të mushtit dhe më pak të verës, nga njëra enë në tjetrën. Rienësimi kryhet për ajrim dhe njëtrajtësim të lëngut, për zbutjen e taninit që përmban, për sqfurim e sidomos për ndarjen e **fundërrisë** prej lëngut. **Sin.:** *Tërheqje, Toçitje, Zhvendosje.* (ang.) *Racking*; (ital.) *Spillatura, Svinatura, Tramutaménto, Traváso, Trombatúra*.

Ripërtëritje e verës: Shtim herë pas here i verës së re tek një verë më e vjetër, për t'i dhënë fuqi të re. (ang.) *Wine regeneration*; (ital.) *Ringiovaniménto del vino*.

Ritharmim: **Tharmim** tjetër, që nxitet e riniset me shtim tharmi dhe sheqeri në **musht**, pasi ka përfunduar tharmimi i parë. Ritharmimi kryhet veçanërisht për **verërat shkumuese**. Po ashtu, **verërat e ëmbla** mund të nisin ritharmimin, çka i ndryshon cilësitë shqisore. Ky lloj procesi ritharmimi mushti, ka të bëjë me teknologji të posaçme. (ang.) *Refermentation*; (ital.) *Rifermentazione*.

Rrëjullë (arb.): Derëz e **butit**, që vendoset në njërën nga të dy anët e sheshta, tek dysHEMEJA ose tek qiellzana e tij. “*Vera po rrjedh nga rrëjulla*” (arb.).

Rrëjullim (arb.): Mbyllje, vulosje e **rrëjullës**, përpara se buti të mbushet me verë.

Stërnik: Vozë e gjatë, që shtrirazi vendoset prapa **çejzës** për bartjen e verës.

Stringël: Copë e zbkuruar prej kartoni të hapur ose të palosur, ku shënohen tregues domethënës për verën dhe kantinën. Stringla vendoset në qafën e shishes me verë, varur me një pé disa ngjyrësh dhe të gërshetuar. **Sin.:** *Stoli, Varëse, Xhingël.* (ang.) *Pendant*; (ital.) *Pendáglio, Frásche, Frasconáia*.

Shishekulluese: Pajisje, mbështetëse prej metali me vendosje pak lart dhe e biruar, ku nga sipër futen shisheet të përmbysura për të kulluar më lehtë pasi janë larë. (ang.) *Bottles-drain*; (ital.) *Scolabottiglie*.

Shishelarëse: Tërësi pajisjesh pastruese dhe çndotëse (dezinfektuese), ku përfshihen: larësja e shisheve, shpëlarësja dhe çndotësja, tërësia e shisheve përpara se të mbushen me verë. (ang.) *Bottle washing devices*; (ital.) *Dispositivo per il lavaggio delle bottiglie*.

Shishembajtëse: Kornizë, skelet dërrase, mbajtëse me dy pjesë në formën e shkronjës A. Shishembajtësja mbështetet në dyscheme, ndërsa kur është me një faqe/pjesë, mbështetet a mbërthehet në mur të kantinës/qilarit ose të shitores. (ang.) *Bottle-holder*; (ital.) *Portabottiglie, Rastrelliera*.

Shishembushëse: Pajisje për shishezimin e verës. Në kantina të vogla dhe në prodhimin shtëpiak shishembushësja mund të jetë e thjeshtë dhe të punohet me dorë; një gyp plastik i tejdukshëm, në trajtë sifoni, vendoset në enën me verë dhe nga ana tjetër e gypit, vera zbrazet duke mbushur shishet. (ang.) *Wine bottling machine*; (ital.) *Linea d'imbottigliamento*.

Shishepjerrëtim: Ndërrim shkallë-shkallë i vendosjes së shisheve me verë shkumuese, nga qëndrimi shtrirë në atë përmbys, gjithashtu duke i rrotulluar sadopak; ky veprim kryhet në mënyrë të caktuar dhe herë pas here, në shishet e vendosura në shishembajtëse me verë shkumuese. Me këtë veprim 21 ditor, duke rrotulluar vrullshëm dhe tejpjerrëtuar në mënyrë të shkallëzuar shishet me verë, mundësohet që tharmet e fundërruara të grumbullohen në grykat e shisheve. (ang.) *Riddling*; (ital.) *Setacciaménto*.

Shishezim: Tërësia e veprimeve për mbushjen e verës nëpër shishe: larja e shisheve, mbushja, taposja, kësulimi, etiketimi. (ang.) *Wine's bottling*; (ital.) *Imbottigliamento, Infiascaménto del vino*.

Shishezuese në rresht: Makinë për mbushjen me verë të shisheve, me anë të sqepave mbushës. të ngulitur dhe të vendosur në radhë/rresht, duke mbushur njëkohësisht disa shishe. (ang.) *Lined bottling machine*; (ital.) *Imbottigliatrice*.

Shishezuese rrotulluese: Makinë për mbushjen me verë të shisheve, me anë të sqepave mbushës. që rrotullohen rreth një boshti: shishet janë të mbushura pasi kryejnë një rrotullim. Kjo makinë është më e përshtatshme sesa ajo shishezuese në rresht. (ang.) *Rotative bottled machine*; (ital.) *Imbottigliatrice rotativa*. *Shishkë* (sin.) *Shih: Faqore*. *Shih: Pagure*.

Shitore vere: Shitore e specializuar për verë, ku mund të tregtohet edhe ndonjë pije alkoolore tjetër. Shitorja gjithashtu tregon pajisje për mirëmbajtjen dhe pirjen e verës, libra dhe revista për verën etj. **Sin.:** *Verëtore*. (ang.) *Wine shop*; (ital.) *Negózio del vino*.

Shklluqje: Pirje njëherësh e bardhakut me verë ose me raki. **Sin.:** *Shkullim, Pirje me fund*.

Shkumim: Shkumim që shkaktohet nga dyoksidi i karbonit, që përmbahet në verë në shkallë mbingopjeje. Shkumimi shquhet kur vera e mbyllur në shishe ndodhet nën sadopak shtypje dhe menjëherë del tek shtypja e mjedisit, kur vera zbrazet në bardhak. (ang.) *Foam forming*; (ital.) *Formazione della spuma*.

Shsqufurim: Largim i dyoksidit të sqfurit, që përmes sqfurimit është futur në musht dhe/ose në verë. Sipas normativave të BE, shsqufurimi lejohet vetëm me veprime fizike. (ang.) *Desulphurisation*; (ital.) *Desulfitazione*.

Shtaposje: Heqje e tapës nga shishja ose nga enët e tjera me verë.

Sthartim: Shtim sheqeri në musht, që përmban 6–8 g/l thartor mollor dhe zhvillim tharmimi alkoolor në temperaturë 25°C, për të mos u krijuar thartor uthullor. **Sin.:** *Çacidizim*. (ang.) *Deacidifying*; (ital.) *Disacidificazione*.

Taposëse: Makinë për futjen e tapës në shishe, që mund të jetë vegël dore ose e mekanizuar. (ang.) *Corker*; (ital.) *Tappatrice*.

Trokullim: Shtrydhje e rrushit, që kryhet me anë të **trokullës**, për të ndarë lëngun nëpërmjet rrjedhjes, prej **lëvoreve** dhe **farave**. **Sin.:** *Ndrydhje, Shpërthiqje, Shtrydhje, Trajllim* (arbë.). (ang.) *Crushing*; (ital.) *Torchiatúra, Pigiatúra*.

Tymëzim i vozave: Proces pune për shterpëzimin e vozave, duke djegur squfur brenda në vozat e mbyllura. (ang.) *Barrels fumigation*; (ital.) *Fumigazione delle bótte*.

Tharbtore: Kthinë ose ndarje e veçantë, mjedis pune në kantinë ose qilar, ku vendosen enët e posaçme dhe kryhet tharmimi i mushtit. **Sin.:** *Tharbcojé, Tharmëtore*.

Tharmëzim: Shpërndarje, mbjellje e tharmeve në musht, përpara ose gjatë tharmimit, mundet edhe pas. Tharmëzimi ka për qëllim rifillimin e tharmimit, kur mushti ende përmban sheqer të reduktuar që mund të shndërrohet në alkool. (ang.) *Leavening*; (ital.) *Lievitatúra*.

Tharmuese: Enë zakonisht prej druri, por në prodhimin industrial, gjerësisht përdoren enë/cisterna inoks, ku **mushti tharmohet**. **Sin.:** *Fermentuese*. (ang.) *Fermentator*; (ital.) *Fermentatóre*.

Thartorim: Shtim **thartori tartor** në musht ose në verë, ku vërehet pamjaftueshmëri **athëtie**, duke përdorur deri 4 g/l dhe vetëm një herë e duke njoftuar organin, institucionin përkatës. Një mënyrë tjetër është duke futur kokrra rrushi të papjekur në musht. **Sin.:** *Acidim*. (ang.) *Acidification, To acidulate*; (ital.) *Aciduláre*.

Thartosh: Lëng rrushi i athët, që përftohet nga **shtypja** dhe **shtrydhja** e vileve me kokrra të papjekura mirë. (ang.) *Verjuice*; (ital.) *Agrestino, Agrésto*.

Uthulltore: Mjedis i përshtatshëm, ku uthulla prodhohet dhe moshohet e ruhet. (ang.) *Vinegar producing-storing environment*; (ital.) *Acetáia*.

Verëtar: I. Njeri kryesisht profesionist, që ka si mjeshtëri prodhimin ose tregtimin e verës; ndodh që verëtari prodhon dhe, po ashtu, tregton verë. II. Njeri i cili, në **qilar** a në **kantinë** prodhon verë, edhe nëse jo me rrushin e prodhuar prej tij ose vera nuk është prodhuar drejtpërdrejt nga duart e veta. **Sin.:** *Palemintaru* (arb.), *Venar, Verëbërës, Verëshitës*. (ang.) *Wine-groëer, Wine-maker Wine-seller*; (ital.) *Vinaiólo, Vináio, Vinicoltóre*.

Verëtarí: Shkencë dhe sidomos praktikë, tërësia e studimeve dhe e veprimtarive që lidhen me prodhimin e verës. **Sin.:** *Enologji, Venari*. (ang.) *Winemaking, Viniculture*; (ital.) *Vinicoltúra*.

Verëtim: 'Veshje' me sadopak verë e bardhakëve të kremtuesve, me qëllim shpëlarje përfundimtare dhe për më shumë familjaritet midis kremtuesve. Nga shishja e sapohapur, zbrazet pak verë në bardhakun e parë, që me ngadalë rrotullohet duke veshur faqen e brendshme; kjo verë, kalohet nëpër bardhakët e disa kremtuesve, duke kryer të njëjtin veprim. (ang.) *Wineglass rinsing*; (ital.) *Avvináre*.

Verëzim: Tërësia e proceseve të para në verëtari, ku përfshihen **shtypja/dërmimi, tharmimi, zbrujtja, shtrydhja** e lëvoreve (kur prodhohet

Zhvillimi i terminologjisë shqipe të verëtarisë në kohën tonë

verë e kuqe), **rienësimi**, **filtrimi**. Pra derisa përftohet verë e **stabilizuar**, gati për t'u **pjekuruar** dhe/ose **moshuar**. **Sin.:** *Vinifikim*. (ang.) **Vinification**; (ital.) **Vinificazione**.

Zhgazim: Veprim që mundëson mënjanimin e një sasie **dyoksidi karboni** dhe oksigjeni, të tretur në verë. Zhgazimi zakonisht kryhet duke gurgulluar azot në verë. (ang.) **Degasation**; (ital.) **Degassaménto**.

BIBLIOGRAFI

- A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.
A. Duro, *Terminologjia si sistem*, Tiranë, 2001.
A. Shundi, *Enciklopedi për vreshtarinë dhe verëtarinë*, Tiranë, 2012.
E. Likaj, M. Çabej, *Morfologji e shqipes standarde*, Tiranë, 2013.
Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.
Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002.
J. Thomai, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.
Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, Tiranë, 1972.
Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, Tiranë, 1972.
Studime mbi leksiku dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, III, Tiranë, 1989.
Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, I, Tiranë, 1980.

